



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.978/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nehat Idrizi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Hunaida Pasuli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., që të gjithë nga Kanada, të cilët i përfaqëson Z.D dhe R.T., avokatë në Prizren, sipas autorizimit, kundër të paditurve: V.B. nga Shtërpca, të cilën e përfaqëson R.K., avokat në Prizren, sipas autorizimit, i cili është përfaqësues i përkohshëm i të paditurve të tjerë S.M., D.S., S.S dhe Z.B. nga Beogradi, fshati, rr. “.....” nr... si dhe V.N., O.L.N. dhe M.R. që të gjithë nga Beogradi, fshati, rr. “.....” nr... A, për vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarve të paditësve e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.102/12, i datës 10.11.2017, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 13.07.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e autorizuarve të paditësve: L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., që të gjithë nga Kanada, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.102/12, i datës 10.11.2017, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.102/12 i datës 10.11.2017, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., që të gjithë nga Kanada, përmes të cilës kanë kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit janë bashkëpronar me të drejtën e pronës prej 1/5 në palujatshmërinë - ngastrat kadastrale me nr..... të dyja në Zonën Kadastrale Petrovocë, për të cilën obligohet e paditura V.B. që në emër të kompensimit për paluajtshmëritë të evidentuara me nr... dhe, të paguaj shumën prej 140.000 €, me kamatë ligjore duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që: Masa e përkohshme e sigurimit e caktuar nga ane e kësaj gjykate me aktvendimin C.nr. 102/12 e datës 20.04.2012, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohen paditësit L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., që të gjithë nga Kanada, që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguajnë të paditurve shumën në lartësi prej 3.806.40

€, brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi të autorizuarit e paditësve brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që në tërësi të aprovoj kërkesëpadinë e precizuar të paditësve dhe nëse gjykata nuk e aprovon propozimin atëherë lënda të prishet dhe ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i të paditurve ka propozuar që të refuzohet ankesa e paditësve e paraqitur nga përfaqësuesit e tij të autorizuar si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarve të paditësve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 03.02.2012, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, për vërtetimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, kundër të paditurve, të precizuar si në parashtresën e datës 27.10.2017, me të cilën kanë kërkuar që të: Aprovohet kërkesëpadija e paditësve dhe vërtetohet se L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., janë bashkëpronarë me nga 1/5 të paluajtshmërive me këto ngastra kadastrale: të evidentuara në certifikatën mbi të drejtat e pronës në pluajtshmëri UL-71813076-00253 ZK/ si dhe ngastra kadastrale me nr.... dhe, të evidentuara sipas Certifikatës mbi të Drejtat e Pronës në paluajtshmëri UL-71813063-00227 ZK, Petrovë, kështu që detyrohen të paditurit që të pranojnë këtë fakt njëherit duke lejuar regjistrimin e këtyre paluajtshmërive në librat publik në Zyrën Kadastrale në Prizren. Detyrohet e paditura V.B. që në emër të kompensimit për paluajtshmëritë e evidentuara me nr. të ngastrës kadastrale ... dhe të paguaj shumën prej 140.000 €, me kamatë ligjore, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare. Njëherit të paguajnë shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.102/12 i datës 10.11.2017, me të cilin ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditësve L.J.D., D.J.Z., S.J.Z, M.J dhe Zh.J., që të gjithë nga Kanada, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve duke marr për bazë faktin se i ndjeri P.K. ka vdekur me datë 08.03.1970 apo para më shumë se 47 vite dhe se deri në paraqitjen e kësaj padie (viti 2012) këtu paditësit nuk kanë treguar asnjë interesim për pasurinë e paluajtshme të të ndjerit P.K., duke mos bërë asnjë propozim në lidhje me shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të të njëjtit apo realizimin e testamentit. Ndërsa, duke u bazuar në ligjet e

lartcekura, del se e drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda 1 viti nga dita që trashëgimtari ka marr në dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjet duke e llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament, nga shpallja e testamentit, që në rastin konkret e ëma e këtu paditësve ishte në dijeni për testamentin në të cilin thirren paditësit për fitimin e të drejtës së pronësisë qysh në vitin 1966 dhe se nga ajo kohë nuk ndërmer asnjë veprim për realizimin e të drejtës së vet edhe pse e njëjta kishte ndërruar jetë në vitin 2008. Kjo nuk do të thotë se në këtë çështje kontestimore ka kaluar edhe afati objektiv 10 vjeçar, përkatësisht ai 20 vjeçar për poseduesin me keqbesim sepse konform dispozitave ligjore të lart cituara kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për parashtrimin e kërkesës për të kërkuar vërtetimin e së drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, përkatësisht pasurinë trashëgimore (padia e paditësve është parashtruar në gjykatë në vitin 2012) që do të thotë pasi që kanë kaluar disa dekada nga vdekja e të ndjerit P.K., apo që nga koha e lënies së testamentit të tij (viti 1966). Sa i përket masës së përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr. 102/12 i datës 20.04.2012 gjykata ka vendosur që e njëjta të mbetet në fuqi deri në përfundim të plotfuqishëm të këtij kontesti, në mënyrë që të mos vije deri te shkaktimi i ndonjë dëmi të pariparueshëm për palët ndërgjyqëse, përkatësisht palës paditëse.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 20 paragraf 1, 21, 28 paragraf 1 dhe 3, 27, 33, 34 dhe 35 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP-së), nenit 127 të ish Ligjit për Trashëgiminë (KSAK), nenit 138 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës (LTK), nenit 36 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, lidhur me nenin 7 paragraf 1, 17 paragraf 2, 41, 67 dhe 143 paragraf 1 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarve të paditësve se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të pa kontestuar i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 138 paragraf 1 të Ligjit për Trashëgiminë të Kosovës (LTK), përcaktohet se: “ E drejta për të kërkuar pasurinë trashëgimore, si trashëgimtar i trashëgimlënësit parashkruhet ndaj poseduesit me mirëbesim brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka marr në dijeni për të drejtën e vet dhe për poseduesin e sendeve nga pasuria trashëgimore dhe në çdo rast jo më vonë se 10 vjet duke llogaritur për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kurse për trashëgimtarin me testament nga shpallja e testamentit”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Ndaj poseduesit me keqbesim, kjo e drejtë parashkruhet brenda 20 vjetësh, nga koha e parashikuar në paragrafin 1, të këtij ligji”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditësve për të kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, përkatësisht pasurinë trashëgimore është parashkruar, për arsye se në këtë rast i ndjeri P.K., këtu trashëgimlënësi i paditësve ka vdekur në vitin 1970, gjegjësisht para më shumë se 47 vite, ndërsa paditësit padinë në gjykatë e kanë paraqitur me datë 03.02.2012, e nga kjo rezulton se nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit P.K. e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë kanë kaluar disa dekada dhe se në këtë çështje kontestimore përveç afatit subjektiv prej 1 viti ndaj poseduesit me mirëbesim, ka kaluar edhe afati objektiv prej 10 viteve, përkatësisht 20 vite për poseduesin me keqbesim.

Gjykata e Apelit vlerësimin juridik si në pikën II, dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se kërkesa e paditësve për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit është në tërësi e bazuar duke u mbështetur në dispozitat e nenit 297 të LPK-së, për arsye se propozuesit e sigurimit e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tyre.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1, pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.978/18, me datë 13.07.2022

Kryetari i kolegjit
Nehat Idrizi, d.v